Drive

PORSCHE
ALBANIA

06/20

KUR LËVIZJA NDAL
WHEN THE WORLD STOPS

04 Rifillimi Duhet të Jetë Optimist!"
"Recovery" Should Be Optimistic!"

12 Audi S8

18 Makina Ime 2.0

Përmbajtja
Content

ŠKODA KAMIQ 06

Coca-cola Albania përqafon teknologjinë e makinave elektrike
Coca-cola Albania moves forward and embraces ev's 08

Masat dhe rregullat gjatë Covid-19 në Porsche Albania
Measures and rules during Covid-19 in Porche Albania 10

Caddy i Ri
New Caddy 20

Revista Drive është një botim periodik i Porsche Albania.
Realizimi: Botues Porsche Albania
Realizimi grafik: Source One

Burimi: Audi:
Audi-Mediaservice.com
SEAT: media.SEAT.com
Volkswagen Makina Tregtare:
volkswagen-media-services.com
Volkswagen Magazine
ŠKODA: press.ŠKODA-auto.com

Për komente, pyetje apo sugjerime lutem na kontaktoni në adresën elektronike office@porsche.al ose në numrin e telefonit: +355 (04) 240 74 30.

Porsche Albania
Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 7, Rr. Monun.
Telefon: +355 (04) 240 74 30,
Fax.: +355 (04) 240 74 34,
e-mail: office@porsche.al; http://www.porsche.al

I dashur lexues,
Dear Reader,

Jona Njocko - Menaxhere e Burimeve Njerëzore dhe Oficere Integriteti
Human Resources Manager and Integrity Officer

'Ne, jo unë!' – në kohën e pandemisë
'We, not me!' – during the pandemic

Ne, jo unë! – qëndron për bashkëpunimin, për solidaritetin ndaj skuadrës, për sinergjinë e kontributit të përbashkët, dhe për rëndësinë e të vepruarit si një ekip kompakt. 'Ne, jo unë!' nuk është një shprehje e krijuar për këtë artikull, por është një prej parimeve kryesore të Grupit Volkswagen dhe një parim i përqafuar më së miri në skuadrën tone të Porsche Albania. Kultura e kompanisë sonë mëshon fort në atributet që shfaqen në punën e përditshme dhe ky parim natyrshëm u bë pjesë e shprehisë dhe praktikës së bashkëpunimit në Porsche.

Gjatë kësaj kohe pandemie, bashkëpunimi dhe mirëkuptimi kaluan vijën e të qënit terma motivues dhe u shfaqën tek të gjithë ne. Ne përshtatëm oraret, proceset e punës, nga '8-të orarshi' në zyrë kaluam në "smart working" – puna nga shtëpia, kolegët përmbushën detyrat edhe në kushtet e pasigurisë që na kishte stepur të gjithëve. Fokusi i të gjithëve ne ishte në tejkalimin e kësaj situate. E kjo nuk do të ndodhte nëse nuk do të ndiheshim si një grup i vetëm, që jep për të mirën e përbashkët e sjell si rezultat të mirën individuale.

Këto 2 muaj ishin një sprovë jo vetëm për kompaninë si një institucion por për individin si pjesë e një skuadre, dhe ne ja dolëm të rikthehemi në aktivitetin normal pas 2 muaj e gjysëm të pasigurie. Një skuadër e fortë është motorri i një kompanie të fortë. Ne arritëm që mes kaosit të krijuar të merrnim vendimet e duhura, të ofronim mundësi të barabarta për të gjithë dhe t'ja dilnim të ruanim pozicionet e punës. Të gjithë kontribuam në mënyra të ndryshme që kompania dhe kolegët të mos cënoheshin dhe së bashku mes solidaritetit dhe këmbënguljes për t'ju rikthyer normalitet, ja dolëm të kalonim këtë sfidë të shfaqur në kohë pandemie.

Për rikthimin në normalitet dhe përballjen me sfidat e së ardhmes, ne do të vazhdojmë të udhëhiqemi nga parimet tona dhe do të vazhdojmë të jemi kompania referencë në tregun automotiv, jo vetëm për shërbimin, produktet dhe risitë që sjellim në treg por edhe për bashkëpunimin dhe frymën e skuadrës që percjellim në përditshmërinë tonë.

We, not me! – stands for cooperation, solidarity towards the team, synergy of shared contribution, and the importance of acting as a team. 'We,not me!' Is not an expression written for this article, but it is one of the main principles of Volkswagen Group and a principle best embraced in our Porsche Albania team. Our company's culture s brings out the attributes that appear in our daily work and this principle naturally became part of our practice of cooperation in Porsche.

During the pandemic times cooperation and mutual understanding were not just typical motivating terms, but all of our actions showed these principles. We adapted the schedules, the work processes, from '8 hours' in the office we started applying to 'smart working'. Colleagues accomplished the tasks even in the conditions of the insecurity that had captivated our days. Our main focus was to overcome this situation. This would not have happened if we did not feel like a team, who contributes for the common goods and generates as a result the individual goods.

These 2 months were a test not only for the company as an institution but also for the individuals as part of the team, and we made it to return to normal activity after two and a half months of insecurity. A strong team is the engine of a strong company. We managed to make the right decisions in the midst of the chaos, to provide equal opportunities for all, and to be able to maintain every job position. We all contributed in different ways so that the company our colleagues would not be harmed, and together in solidarity and with the persistence to return to the new normality, we managed to overcome this challenge that came with the pandemics outbreak.

Towards the return to the new normal and facing the future challenges ahead, we will continue to be guided by our core values and principles, and will continue to be the reference company in the automotive market, not only for the services, products and innovations we bring to the market but also for our cooperation and spirit that our team conveys in our daily lives.

RIFILLIMI DUHET TË JETË **OPTIMIST!”**

“RECOVERY” SHOULD BE **OPTIMISTIC!”**

Gentian Bushati - Drejtor i Përgjithshëm Porsche Albania
General Manager Porsche Albania

‘‘Në këto momente është e vështirë për të krijuar pritshmëri të sakta mbi të ardhmen, por duke vepruar në mënyrë të shpejtë për t’iu përgjigjur nevojave dhe kërkesave të klientëve në këtë periudhë krize, si në çdo kohë, rifillimi duhet të jetë optimist!’’

Shëndeti i punonjësve, klientëve dhe vizitorëve tanë ishte në fokusin e stafit menaxherial të Porsche Albania. Duke respektuar të gjitha udhëzimet e autoriteteve publike, siguruam të gjitha masat mbrojtëse higjeno - sanitare ndaj përhapjes së Covid-19. Ne arritëm të ndërtonim një model të ri biznesi duke ndërtuar aktivitetin e përditshëm në digjitalizim të shërbimeve dhe punë nga shtëpia. Për mua, si pjesë e stafit drejtues të kompanisë, kjo qasje e re ishte një mësim i vlefshëm që nxorri në pah fleksibilitetin dhe përshtatjen përballë kësaj sfide të re. Dhe sfida u paraqit me të gjithë forcën e saj!

Referuar të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, tregu automotiv i makinave të reja përgjatë tremujorit të parë të vitit 2020 pati një rënie prej 18% krahasuar me të njejtën periudhë në vitit 2019.

Të tërhiqeshe dhe të mbyllje dyert e kompanisë ishte opsioni i parë dhe më i thjeshtë për tu zgjedhur, por dalja në frontin e parë duke u përballur me një kërcënim të panjohur e duke iu gjendur pranë partnerëve të biznesit, të cilët ishin heronjtë e kësaj lufte, ishte zgjedhja e duhur. Një armë e fortë në këtë betejë ishte edhe digjitalizimi i mëtejshëm.

Zhvillimi i mëtejshem i aplikacionit “Makina Ime” ishte një përgjigje në kohë reale të kërkesave të çdo përdoruesi duke filluar nga zhvillimi i shërbimit të autorizimit të daljes, duke vazhduar me opsionin “Shoferi Im” dhe duke kulmuar me zhvillimin e opsionit të lojës së re.

Gjatë muajit Prill e fillimit të Majit, srategjia jonë ishte të fokusoheshim në aktivetin e pas shitjes duke sjellë oferta të reja dhe konkurruese:

1. Fushata “Pick-up, Drop off” nëpërmjet partnerëve tanë të besueshëm të Car-Tier ku përdoruesve të “Shoferi Im” iu mundësua marrja e makinës tek dera e shtëpisë dhe rikthimi me të gjitha shërbimet e kryera.
2. Shërbimet periodike të automjeteve.
3. Higjenizimi i makinës, si lehtësim i shqetësimit më kryesor të asaj periudhe.

Megjithëse në terma financiar kompania Porsche Albania pati një luhatje të konsiderueshme financiare si pasoje e pezullimit të aktivitetit tregtar, ne gjetëm forcë tek menaxhimi efikas i një prej aseteve tona më të çmuara: Burimet Njerëzore! Siguria shëndetësore, riorganizimi i punës dhe ruajtja e çdo vendi pune, ishin disa nga themelet e forta që përballuan “tërmetin” e pandemisë. Në moton “Ne, jo unë.” e gjithë struktura jonë njerëzore u udhëhoq nga një ndjenjë e pashoq solidariteti duke u shndërruar në një moment frymëzimi që do të rrezatojë gjatë në kohë.

Muaji Maj filloi të shfaqë dritë jeshile në aspektin e mobilitetit, dritë e cila u reflektua menjëherë edhe në ecurinë e 3 javëve të para ku shumë tregues të aktivitetit u kthyen në kushtet e mëparshme. Si një shpërblim për klientët e mëparshëm dhe si një ftesë për klientët e rinj, Porsche Albania ka ndërtuar një paketë ofertash në të gjitha brandet.

Çdo brand ka sjellë oferta dhe mundësi fantastike, ku çdo biznes apo individ, i ri apo i vjetër, të mund të bëjë të vetën makinën e tij nën emrin e markave tona.

Mendoj se është e sigurt të thuhet se mbështetja tek vlerat e kompanisë tonë rezultoi i bazuar drejtë. Përpjekjet tona për t’ju gjetur pranë të gjithë atyre që na kanë besuar ndër vite, solli përballimin me sukses të situatës.

“During such times, it is difficult to pin accurate expectations for the future. However, by promptly responding to the needs and requirements of our customers during this crisis, recovery should be quite optimistic!”

The health of our employees, customers and visitors was at the focus of the management of Porsche Albania, acting in compliance with all the instructions of public authorities and providing all hygienic and sanitary protection measures against the outbreak of Covid-19. We managed to build a new business model by designing our daily activity towards digitalization of services and work from home. For me, as part of the company’s management, this new approach was a valuable lesson that pointed out our flexibility and adaptability to this new challenge. And the challenge appeared stronger than ever!

With reference to the data issued by the General Directorate of Road Transportation Services, the automotive market of new cars during the first quarter 2020 decreased by 18% compared to the same period in 2019.

Drawing back and closing the doors of the company was the first and easiest option to choose. On the other hand, standing out on the front line and facing such unknown threat by being close to our business partners, the heroes of this war, represented the right choice. Our strongest weapon in this battle was further digitalization.

Further developments of the features on the application Makina Ime / My Car, represented real-time responsiveness to the needs of each user, including the development of the Lockdown Permit Authorization feature and Shoferi Im / My Driver option, as well as the development of the new game option.

During April and the beginning of May, our strategy was focusing on the after-sales activity, launching new and competitive offers:

1. The Pick-up, Drop off campaign by our trusted Car-Tier partner, where Shoferi Im / My Driver users could benefit from the new service of car pick-up and drop-off after all services had been performed.
2. Periodic vehicle services.
3. Car disinfection, for easing down the main concern of this period.

Although in financial terms Porsche Albania suffered significant financial fluctuation as a result of the suspension of commercial activity, our strength lied in the efficient management of one of our most valuable assets: Human Resources! Health protection, job reorganization, safety at work and avoidance of unemployment were some of the strongest pillars that Car disinfection, for easing down the main concern of this period. Under the motto “We, not me”, all our human resources was guided by an excellent sense of solidarity, therefore becoming an inspiration that will radiate our
business path over time.

The month of May lit the green light in terms of mobility, which was immediately reflected in the business performance of the first 3 weeks, by reviving many indicators of our business activity. Therefore, as a reward for existing customers and as an invitation to new customers, Porsche Albania launched a new package of offers including all our brands.

Each brand introduced fantastic offers and opportunities, where every business or individual, young or old, can buy their own brand car.

I believe it is safe to say that relying on our company’s core values proved to be right, and our efforts to stand besides those people who trusted us over the years led us to successfully cope with the occurring situation.

Kush KAMIQ BOTËN KA

Në mesin e muajit Shkurt 2020 Škoda Albania zhvilloi tek "Kalaja e Tiranës" një lojë të quajtur "Kush KAMIQ botën ka". Arsyeja ishte pasurimi i portofolit së Škoda me një SUV , më e vogla e familjes e quajtur Kamiq.

KAMIQ vazhdon gjuhën e suksesshme të dizenjos SUV nga KODIAQ dhe KAROQ dhe vjen me elementë të rinj vizualë të tilla si fenerët e ndarë që përmbajnë dritat e ditës mbi ato kryesore, e pa aplikuar kjo më parë. SUV-ja qytetit bazohet në platformën MQB dhe me një gjatësi prej 4,241 mm, ofron hapësirë të bollshme, ashtu si çdo ŠKODA. Sistemet e sigurisë dhe të sistemet e informacionit e multimedias (infotainment) janë 2 nga copëzat më kryesore jo vetëm të KAMIQ por edhe të të gjithë brandit. KAMIQ është vlerësuar me 5 nga 5 yje të mundshme nga testuesit e sigurisë së makinave EURO NCAP. Nga ana tjetër sistemi sistemet e informacionit e multimedias (infotainment) Amundsen, me versionin më të ri ekskluzive tek SCALA dhe KAMIQ, përmban SmartLink, navigim 3D, kontroll nëpërmjet xhesteve, e shumë opsione të tjera që e bëjnë KAMIQ një makinë perfekte përsa i përket prakticitetit të përdorimit.

I shqiptuar "Kamik" por i shkruajtur "Kamiq", emri i këtij modeli koiçidon jo vetëm me fjalët shqip "ka mik" por edhe me faktin që ajo është një makinë dedikuar rinisë, shoqërisë së mirë e momenteve të bukura. Ndaj vendosëm që për prezantimin e saj në tregun e vendit tonë të bënim diçka më ndryshe nga eventet tradicionale të natyrës së tillë.

Për ata që nuk e dinë, në fillimet e saj Škoda ka qenë një kompani prodhimi biçikletash, dhe kjo është edhe arsyeja përse dy rrotaku është një pjesë e pa ndarë e kompanisë nga Mladá Boleslav e Republikës Çeke.

Edhe sot kompania ka një gamë të gjerë biçikletash të shumllojshme, që nga klasiket e deri tek ato elektrike, për të përmbushur kërkesat e thuajse çdokujt që kërkon një biçikletë.

Duke lidhur të gjitha këto bashkë, menduam që të shpërblejmë me një biçikletë dikë që me të vërtetë KA MIQ.

Gjithçka ishte shumë e thjeshtë. Tek Kalaja e Tiranës nga data 13 deri më 16 Shkurt, një KAMIQ u vendos pranë hapsirës ekspozuese të vendit në fjalë, dhe veç të tjerash një nga gjërat që të bënte përshtypje ishte një selfie stick gjigand. Fitues i biçikletës bëhej ai që sillte numrin më të madh të miqve për të bërë një selfie pranë makinës.

Gjithçka filloi qetë me grupe të ndryshme me nga rreth 40-50 veta, por dita e dielë datë 16 ishte ajo më kulminante. Dita filloi me një grup të madh prej 105 miqsh dhe teksa orët kalonin, grupe më të mëdhenj nuk po vinin. Kur po i afroheshim mbëmjes, filluam të mendonim se tashmë e kishim një fitues por gjithçka ndryshoi momentet e fundit. Dikush arriti të sjellë 147 miq për të bërë një selfie! Aq shumë persona sa makina u mbulua tërësisht dhe slogani i lojës "Kush KAMIQ botën ka" mori një dimension tjetër.

Fituesi i lojës kështu zyrtarish u bë Edrin Fidhe me të cilin patëm edhe një bashkëbisedim të shkurtër:

ŠA: Edrin keni urimet tona për fitoren e lojës dhe jemi të lumtur që bëheni akoma edhe më shumë pjesë e familjes Škoda!

EF: Edhe unë ju falenderoj për mundësinë që na dhatë!

ŠA: Do donim të dinim si fillim, si u informuat mbi këtë lojë?

EF: Në fillim fare e pashë në aplikacionin tuaj Makina Ime kur më erdhi si njoftim. Duke qenë klient i Škoda kam shkuarkuar aplikacionin dhe aty qëndroj në kontakt me ju virtualisht.
Më pas e pashë edhe në madiat tuaja sociale.

ŠA: A jeni aktualisht përdorues i një biçiklete?

EF: Kam qënë dikur shumë, por jo më, por biçikletën vazhdoj ta kem një pasion timin. Edhe stili i jetesës që bëj, puna dhe angazhimet më mbajnë tepër të lidhur me makinën. Tani mendoj se duhet të filloj të bëj disa ndryshime.

ŠA: Si ka filluar historia juaj me Škoda?

EF: I kam pëlqyer shumë makinat. Kam patur disa makina dhe makina e fundit që kam blerë është pikërisht Škoda Superb Laurin & Klement Edition 4x4. Është e fuqishme dhe i bën ballë terreneve me dëborë që i has shpesh sepse kam shtëpinë në fshat. I ndërroj gomat në bazë të stinëve dhe rrugëtimi bëhet shumë i sigurt dhe i këndshëm.

ŠA: A mendoni në vazhdim të merrni një tjetër Škoda?

EF: Në fakt, po. Mendoj që Kodiaq do të jetë zëvendësues i mirë i Superb sepse ka shumë hapësirë, është e lartë nga toka dhe mendoj që do i shkojë shumë edhe biçikleta ime e re që do filloj ta marr me vete.

In mid-February 2020, Škoda Albania organised a game called "Who owns a KAMIQ, "Who owns a KAMIQ, owns the world" at Tirana Castle. The focus was to enrich the Škoda fleet with a SUV, the youngest member of the KAMIQ model range.

The new KAMIQ continues the successful SUV design language of the KODIAQ and KAROQ SUVs, whilst the split headlights, which feature daytime running lights above the main headlight, constitute new striking visual features as never applied before. The city SUV is based on the MQB platform, at 4,241 mm long, offering a generous amount of space, just as any ŠKODA does. Security and infotainment systems are 2 of the most important features not only for KAMIQ but also for the entire brand. With the agility of a compact car, KAMIQ was awarded 5 out of 5 stars safety rating by the comprehensive Euro NCAP crash and safety tests. Furthermore, the SCALA and KAMIQ feature the all-new exclusive Amundsen infotainment system, including SmartLink, 3D navigation, gesture control and other numerous options, making KAMIQ the ideal car for practical use.

Pronounced as "Kamik" and spelled as "Kamiq", the model name coincides with the Albanian expression "ka mik" (has friends) and makes it the car dedicated to young people, friendship and unforgettable moments. For this reason, we decided to launch KAMIQ in the Albanian market in a more particular way trather than similar conventional events.

For everyone who does not know, Škoda was initially founded as a bicycle manufacturing company, and this is why the two-wheeler is an integral part of the company as established by Mladá Boleslav from the Republic Czech.

Nowadays, the company trades a wide range of bicycles, from classic to electric ones, to meet the requirements of almost anyone who is looking for a bicycle.

Considering all these advantages, we were keen to reward with a bike anyone that was really as friendly as "KA MIQ".

During February 13-16th, a KAMIQ was placed at the Tirana Castle at the on-site exhibition space. One of the things that got a lot of attention was a giant self stick. The person who would bring more friends for taking a selfie with the car in the site, would be the winner of the bicycle.

Groups of 40-50 persons approached the car and took selfies every day. Sunday, the 16th marked the Great Day. The day started with a large group of 105 friends. But, as the day went by, no bigger group appeared to take a selfie. As the evening was coming we all thought we had the winner. Surprisingly, the situation reversed at the very last moment. At the selfie corner, someone approached with their 147 friends! There were so many people fitting in one selfie that the car became almost totally invisible. The slogan "Who owns a KAMIQ, owns the world" now was leveled up to a totally new dimension.

The official Winner of the award was Edrin Fidhe, with whom we had a brief conversation:

ŠA: Edrin, congratulations for being awarded Winner of the game! We are extremely happy for you to become a member of the Škoda family!

EF: Thank You for the opportunity!

ŠA: Firstly, we would like to ask you, how did you know on this game?

EF: I initially received a notification from the application Makina Ime / My Car. Being a Škoda customer, I have downloaded this App in my phone where I am in continuous virtual communication with you. After that, I saw your posts in your social media channels.

ŠA: Do you use a bicycle?

EF: I used to have one, but not any longer. However, bicycles are my old passion. My lifestyle, my job and my engagements keep me too much connected to the car. However, I think that it's just about time to start and make some changes.

ŠA: When were you first introduced to Škoda?

EF: I have always been in love with cars since I was very young. In the past, I have driven several brands. Škoda Superb Laurin - Klement Edition 4x4 is what I actually own now. It is very powerful and much suitable for driving on snowy terrain, which suits me bests since I live in a village. I change tyres by season therefore driving becomes much safer and pleasant.

ŠA: Do you think your next car will again be a Škoda?

EF: Yes, indeed I do. I think that Kodiaq will perfectly replace Superb given its larger interior spacing, higher ground clearance, and I also think that my new bicycle will fit perfect with it and that I should start taking with me.

COCA-COLA ALBANIA

NJË HAP PËRPARA, PËRQAFON TEKNOLOGJINË E MAKINAVE ELEKTRIKE

MOVES FORWARD AND EMBEACES ELECTRIC VEHICLES

Elektrifikimi i industrisë automotive është tashmë një realitet i prekshëm jo vetëm në botë por edhe në Shqipëri. Mjafton ti hedhim një sy statistikave dhe gjithçka bëhet më e qartë. Në 10 vitet e fundit, ato janë kthyer nga "projekte futuristike" në një lloj mjeti të aksesueshëm lehtë nga të gjithë ne.

Makina të vogla, sedan, SUV, hatchback, biçikleta, motoçikleta, autobusë e së fundmi kamiona të tonazhit të rëndë kanë versionet e tyre elektrike, madje të afta të kryejnë shumë kilometra me një karikim të plotë.

Në vendin tonë ato i hasim së tepërmi tek taksitë, kompanitë e ndryshme por edhe tek individët.

Së fundmi, edhe kompania Coca-Cola Bottling Shqipëria vendosi që të elektrifikojë flotën e saj të shitjes për Tiranën, me 2 modele Volkswagen elektrike e-Golf dhe e-Up. Një flotë bashkëkohore e cila i shërben kompanisë duke ulur shpenzimet operacionale të flotës së saj, por edhe duke dhënë kontributin e saj në aspektin ekologjik.

Për të mësuar më shumë mbi këtë projekt të kompanisë, patëm kënaqësinë të realizojmë një intervistë me Z. Luca Busi, president i CCBS (Coca-Cola Bottling Shqipëria).

Përshëndetje Z. Busi!
Përse vendosët që të shtoni mjete elektrike në flotën tuaj?

Ky investim strategjik është hapi i rradhës në një seri angazhimesh që CCBS ka ndërmarrë ndër vite në mbrojtje të mjedisit. Angazhime të tilla gjenden të materializuara në mbështetjen që CCBS ka mundësuar për projekte madhore mjedisore apo në ndryshim të praktikave të saj ditore tregtare.

"Green Mobility" është një nismë e financuar tërësisht nga Coca-Cola Bottling Shqipëria, e cila synon përmirësimin e cilësisë së ajrit me një flotë të re prej 56 makinash Volkswagen 100% elektrike, të cilat do të sjellin reduktimin e 178 ton CO2 të emetuara çdo vit, sasi kjo e barabartë me përthithjen që kryejnë 13,327 pemë në vit.

Duke ndjekur suksesin 6 vjeçar të "Green Mobility" në Itali, Kompania Coca-Cola mbështet dhe inkurajon Shqipërinë në aktivitetin e saj të gjelbër.

Investimi "Green Mobility" është një kontribut dhe shembull real që rrit ndërgjegjësimin për rolin që të gjithë ne kemi ndaj mjedisit.

Kjo nuk është një ëndërr, por puna jonë e përditshme. Gjithashtu ky është fillimi i qëllimit tonë madhor për trefishimin e flotës elektrike në të gjithë Shqipërinë dhe po aq reduktimin e CO2, duke ofruar kështu të mirat që ofron një pyll gjigant, çdo vit, për Shqipërinë tonë të dashur. Ky është dhe roli ynë për një Shqipëri më të gjelbër.

Çfarë funksioni kryejnë ato në operacionet e kompanisë?

Makinat elektrike janë tashmë në përdorim që nga marsi i këtij viti, nga flota e shitjes së CCBS të qytetit të Tiranës. Ndiqet program ditor i një përfaqësuesi shitjesh. Kryhen vizitat e rregullta në pikat e shitjes, mbi promovimin dhe shitjen e të gjithë produkteve të portofolit të CCBS, mirëmbajtjen e aseteve të kompanisë, apo identifikimin e çdo klient të ri. Mbulon një qarkullim mesatar rreth 55km/ditë për makinë.

Çfarë infrastrukture keni krijuar për to dhe ku munden këto makina të karikohen?

Aktualisht ne operojmë me 6 pika karikimi (4 karikues të shpejtë dhe 2 standardë) të cilat janë investim i CCBS tek ambientet e parkimit mbi të cilin janë instaluar panelet diellore dhe që furnizojnë makinat me energji të përfituar nga panelet diellore. Gjithashtu gjatë kësaj kohe kemi lidhur disa marrëveshje me Bashkinë e Tiranës dhe kompaninë Green Taxi për shfrytëzimin e karikuesve të implementuar në Tiranë prej tyre. Shpresojmë në të ardhmen të kemi mbështjetje në këtë lloj infrastrukture edhe nga institucione të tjera shtetërore me të cilat po punohet që prej fillimit të këtij projekti.

A keni vënë re ulje të kostos së përdorimit të përditshëm të flotës tuaj të makinave?

Kosto e energjisë elektrike për furnizimin e makinave elektrike është përllogaritur 16% e kostos së karburantit që do të konsumonte një makinë me naftë. Ky vlerësim është bazuar në indikacionet e dhëna në manualin e mjeteve dhe çmimin mesatar të karburantit dhe energjisë elektrike, megjithatë mbetet për t'u vlerësuar në kohë për të qenë më korrekt në këtë këndvështrim.

A mendoni që ta elektrifikoni më tej kompaninë tuaj?

Vlen për t'u theksuar se CCBS është e para kompani e cila po vendos në përdorim një flotë të tërë makinash elektrike në Rajonin e Tiranës. Me pikënisje Tiranën, flota elektrike do të shtrihet në të gjithë Shqipërinë, duke shërbyer kështu si një frymëzim për individët, komunitetet e ndryshme, bizneset dhe institucionet publike për t'iu bashkuar udhëtimit drejt një mënyre jetese më të gjelbër.

Njëkohësisht bashkëpunimit të vendosur me institucione publike si Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bashkia Tiranë, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Posta Shqiptare, Tirana Parking dhe të tjerë partnerë privat si Green Taxi etj., CCBS ka hedhur hapin e parë drejt projektit më të madh: mbulimi i të gjithë flotës së saj në Shqipëri me 197 makina elektrike!

Çfarë ndryshimesh sugjeroni të bëhen në mënyrë që të incentivohet blerja e makinave elektrike më tej?

Ne jemi këtu për të promovuar, mbështetur si dhe për të ofruar një shembull të përdorimit efektiv të mjeteve të qarkullimit me impakt pozitiv. Në të njëjtën kohë, ne kemi nevojë per investimet e duhura në infrastrukturë, rregullatorë në fuqi apo politikat e ndryshme fiskale e sociale, të cilat do të lehtësonin investimet e mëtejshme jo vetëm për bizneset por dhe për individë, për të ofruar një ndikim të jashtëzakonshëm në jetën tonë, në Shqipërinë tonë.

Electrification of the automotive industry has already turned into a tangible reality at a global and national level, including Albania. Just take a look at the statistics and everything becomes clearer. During the last 10 years, they have turned from "futuristic projects" into a kind of tool easily accessible to all of us.

Small cars, sedans, SUVs, hatchbacks, bicycles, motorcycles, buses, and recently heavy-duty trucks have been manufactured in their own electric versions, capable for driving endless kilometres on a single charge.

In our country, we mostly find them in taxis, but also companies and individuals are currently using them.

Recently, the Coca-Cola Bottling Albania company decided to electrify its Tirana's sales' fleet, with 2 electric Volkswagen models, the e-Golf and e-Up. This contemporary fleet serves best to the company by reducing the operational costs of its fleet, and therefore providing its valuable contribution in ecological terms.

To learn more about this company's project, we had the pleasure of conducting an interview with Mr. Luca Busi, President of CCBS (Coca-Cola Bottling Albania).

Greetings Z. Busi!
Can you tell us more on your decision to add electric cars to your fleet?

This strategic investment is the next step towards a series of commitments that CCBS has undertaken over the years to protect the environment. Such commitments are embodied in the support that CCBS has provided to major environmental projects or in enhancing its day-to-day trading practices.

"Green Mobility" is an initiative fully funded by Coca-Cola Bottling Albania, which aims to improve air quality with the new fleet of 56 Volkswagen 100% electric cars. This will reduce the 178 tons of CO2 emitted each year, an amount equal to the absorption performed by 13,327 trees each year.
Following the 6-year success of "Green Mobility" in Italy, Coca-Cola Company supports and encourages Albania in its green initiative.

The Green Mobility investment is a tangible contribution and example that raises awareness of the role we all play for a sound and green environment.

This is not a dream. This is our every day commitment. This is also just the beginning of our major goal of tripling the electric fleet throughout Albania and reducing CO2 emissions, thus providing the benefits that a giant forest offers on a yearly basis to our beloved Albania. It is exactly our role for a greener Albania.

What is their role in company operations?

The CCBS sales fleet in the city of Tirana has been using electric cars since March this year. The daily program of a sales representative is followed. Regular visits are made to the sale points aiming the promotion and sale of all CCBS portfolio products, maintenance of the company's assets and identification of each new customer. Each car covers an average driving distance of about 55km/day.

What kind of infrastructure have you established for these cars and where can these cars be charged?

Currently, we operate with 6 charging points (4 fast chargers and 2 standard chargers) funded by CCBS at our parking lots, where solar panels are installed for energy efficient power supply. Moreover, during this time we have entered into several agreements with the Municipality of Tirana and the Green Taxi company for the use of chargers that they have installed around Tirana. We hope that in the future, other state institutions further support us in undertaking this kind of infrastructure we are working with since the beginning of this project.

Have you noticed any significant cost reduction due to the daily use of your e-car fleet?

The cost of electricity for charging electric cars is calculated at 16% of the fuel cost that a normal fuel-running vehicle would consume. This estimate is based on the indications provided in the vehicle manual and the average price of fuel and electricity. However, in order to be more accurate, this will be assessed better over time.

Do you intend to further electrify your company?

It is worth highlighting that CCBS is the first company operating on an entire fleet of electric cars in the Tirana Region.
Starting with Tirana, the electric fleet will extend throughout the entire territory of Albania, thus representing an inspiring success story to our people, various communities, business entities and public institutions, inviting them to join our journey towards a greener lifestyle.

At the same time, based on the cooperation established with public institutions such as the Ministry of Finance and Economy, the Municipality of Tirana, the Power Distribution Operator, the Albanian Post, Tirana Parking and other private partners such as Green Taxi, etc., CCBS has taken the first step towards a major project: coverage of its entire Albanian fleet with 197 electric cars!

What are the changes you suggest to be made to encourage the purchase of electric cars in the future?

We are here to promote, support and provide an example of the effective use of echo-friendly vehicles. At the same time, we need the appropriate investments in infrastructure, the issuance of related applicable regulations, as well as various fiscal and social policies that would facilitate further investments of similar nature, not only for business entities but also for individuals, to provide a significant and tangible impact to our lifestyle and our beloved Albania.

MASAT DHE RREGULLAT GJATË COVID-19 NË PORSCHE ALBANIA

MEASURES AND RULES DURING COVID-19 IN PORCHE ALBANIA

Përballja me situatën e pazakontë të krijuar nga Covid19 solli për të gjithë ne sfida të reja, të të gjitha niveleve e dimensioneve.

Na u desh të përshtatemi me një mënyrë të re të jetesës, të fillojmë të punojmë nga shtëpia, të mos dalim e të kemi kontakt intensiv me njerëz të tjerë si bëjmë zakonisht, e shumë të tjera.

Por ata të cilët patën një sfidë akoma edhe më të madhe ishin bizneset, të cilëve u lindi nevoja që të përshtaten me këtë mjedis të ri, teksa u duhej që të mund të menaxhonin situatën sa më mire duke minimizuar risqet, dëmet, teksa dëshira e gjithësecilit ishte që të mos kishte shkurtime në vendet e punës.

Në Porsche Albania arritëm që t'i realizonim këto më së miri. Asnjë shkurtim nuk u bë dhe hapëm dyert për here të pare në datë 17 Mars duke i siguruar që kushtet e higjenës të jenë të duhurat.
Njëkohësisht, lindi nevoja që të bëhej higjenizimi i ambjenteve, i cili u krye gjatë gjithë fundjavave dhe vazhdon të kryhet në të gjitha ambjentet e kompanisë. Një pikë tepër e rëndësishme kjo, për të shmangur përhapjen e virusit.

Për këtë në ndihmë erdhi edhe Car-Tier i cili mundësoi që makinat të mund të silleshin në servis nga një prej shoferëve të tyre, duke minimizuar edhe lëvizjen e personave të cilët kishin nevojë që të sillnin makinën pranë servisit.

Në këtë periudhë lindi gjithashtu nevoja e autorizimeve të cilat ishin të nevojshme për të bërë të mundur lëvizjen me makinë. Për këtë integruam brenda aplikacionin tonë Makina Ime opsionin "Autorizime", i cili bënte të mundur që lehtësisht të aplikohej për të marrë një autorizim për të qarkulluar me makinë.

Në të gjitha hyrjet e godinave u vendosën tabela me materiale informuese mbi kujdesin që duhet të kemi ndaj Covid19, gjithashtu u vendosën edhe dezinfektant, doreza dhe maska.
Gjithashtu të gjithë punonjësit u pajisën me një Manual Instruktimi për të përballuar këtë situatë.

Për fat të mirë, tani e kemi lënë gjithçka pas. Jemi të mbushur me energji të reja për të rifilluar aty ku e lamë, por gjithmonë duke u treguar të kujdesshëm për veten e të tjerët.



In the face of the unusual situation caused by Covid19, new challenges emerged for all of us, at all levels and dimensions.

We had to adapt to a new normal, start working from home, stay isolated at home and avoid close contacts with other people as we usually did before.

However, business entities had to cope with the most exhausting challenge. They needed to adapt to this new normal, as they had to strive to remotely manage the reduced workflow by minimizing all potential risks and damages, while trying to avoid job loss.

At Porsche Albania, we managed to cope with this the best way possible. No job losses were recorded, and our facilities were opened for the first time on March 17th, ensuring all the proper hygiene conditions in place.

At the same time,it was required to disinfection of our premises, which was carried out on a weekend basis, covering all the premises of our company, which is a crucial measure to avoid the spreading of the virus.

Car-Tier proved to be of extreme help, enabling car service bookings through their driver's assistance, therefore minimizing physical contacts for people needing their car serviced.

During this period, there was also need for Exit Permit Authorizations necessary for driving around the city. Hence, App. Makina Ime / My Car, introduced the "Authorization" option, which enabled easy applications for Exit Permit Authorizations.

Under these circumstances, we placed informative boards at all building entrances, providing all the necessary information on Covid19 preventive measures, such as disinfestation, face masks, gloves, etc.

Moreover, detailed instructions were made available to all employees to better cope with this situation.

Thankfully, this is now a past story! We now feel full of new energies and eager to resume, keeping in mind that we should be careful for ourselves and our beloved ones.

Audi S8
Takim Virtual
Virtual Launch

[LIVE
STREAMING]

Burimi: News31.al

Pavarësisht se tregu i automjeteve është goditur nga pandemia, si gati çdo sector tjetër, Porsche Albania këtë situatë e ka marrë si sfidë dhe po e shfrytëzon për të na prezantuar me mundësitë e të ardhmes. Si asnjëherë tjetër, kjo kompani, nëpërmjet një prezantimi "live", në linjë me strategjinë e re digjitale të marketingut dhe komunikimit që po zbaton është zbuluar për publikun shqiptar Audi S8, modeli i vitit 2020, trasmetim i cili është parë tashmë nga mbi 139,000 persona. Kjo, i hap rrugën një ere të re të komunikimeve që Porsche Albania do të bëjë në vazhdim, duke iu përshtatur të tashmes dhe duke sjellë gjithmonë risi në tregun vendas.

Audi S8 është një makinë që është larg të qenit vetëm e tillë! Prodhime të tilla, s'kanë nevojë për shumë fjalë sepse vepra flet më tepër e megjithatë, për dashamirësit e Audi por edhe për ju që po mendoni këtë kohë për blerjen e zgjuar të një makine, ky artikull do ju nevojitet me patjetër.

Me fjalë të thjeshta, misioni i një automjeti është që të çojë një njeri nga pika A në pikën B. Audi S8 e realizon këtë mision, por në një mënyrë krejt të veçantë. Për shumë vite kombinimi i sportives dhe luksit në një makinë ka qenë e pamundur. Mesa duket kjo fjalë nuk ekziston për inxhinierët e Audi, të cilët jo vetëm ja kanë dalë që të zhvillojnë një model makine sportiv, ku adrenalina që të dhuron shpejtësia është kryefjala, por është tepër luksoze, me teknologjinë më të fundit, e sigurtë dhe e rehatshme.

Si gjithmonë Audi i ka qëndruar besnik rrënjëve të tij në këtë model, duke ruajtur statusin ikon që mban. Nëse do të futemi në disa detaje, që duhet t'i interesojnë çdo personi përpara se të bëj zgjedhjen për makinën e tij, S8 ka një kabinë prej alumini që i jep fortësi dhe stabilitet. Veçoria e këtij modeli është që edhe pasqyrat e makinës janë prej alumini, ndërkohë që nuk mund të lemë pa përmendur difuzorin sportiv, injeksionin e drejtpërdrejtë dhe 4 marmitat. Gomat plotësojnë bukur të gjitha pjesët e tjera të makinës duke i dhuruar një pamje dinamike por edhe mbështetjen e duhur që të ndiheni komodë në çdo reliev ku makina do të përshkojë. Normalisht, një përbindësh i tillë shpejtësie me 571 kuaj fuqi, i shpejtë si një makinë e tipit Porsche, që ju e dini mirë se çfarë duam të themi, mund të mendoni se e ka vendin vetëm në rrugë të gjata jashtë qytetit? Ky nuk është rasti!

Audi S8 është tepër komod për t'u përdorur në lëvizje brenda qytetit. Falë sistemeve të saj teknologjike, shpenzon më pak litra gjatë udhëtimeve të shkurtra, në mënyrë që jo vetëm të kursejë, por edhe të mbrojë ambientin. Ka një sistem radari të pagabueshëm që studion rrugën dhe distancën nga makinat e tjera. Gjashtë kamera të inkorporuara dhe një sistem amortizimi të tillë, që të mundëson ty si shofer të mos bësh gabime, edhe kur padashje je jashtë shpejtësisë së lejuar.

Siguria e shoferit dhe e pasagjerit është kryesore. Sistemi 360 gradë i tij madje mund edhe të parashikojë një aksident të mundëshëm dhe të minimizojë rreziqet. S8 ka gjithçka për një performancë fantastike. Nëse nuk ju njaftojnë këto, na lejoni të themi që ka edhe një paisje që mund t'ju bëjë kafen herët në mëngjes, kur jeni vonë për punë.

